



Në bazë të kërkesës së Komunitetit të fshatit Irzniq të dt.09.02.2016, nr.01-3911, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e nje objekti te perbashket per nevoja te fshatit, duke u bazuar në nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 25 pika 7 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.29.02.2016, bie këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË PËRBASHKËT PËR NEVOJA TË FSHATIT IRZNIQ

I.

Caktohet lokacioni për ndërtimin e një objekti-shtëpije të vogël të përbashkët për nevoja të gjithë komunitetit të fshatit Irzniq, në një pjesë të parcelës nr.0818-0, Çertifikata P-70505068-00818-0, me kulturë kullosë e klasës 2, vendi i quajtur Trolli, Zona Kadastrale Irzniq, me sipërfaqe të përgjithshme 10173 m², e evidentuar si pronë komunale.

II.

Implementimin e këtij Vendimi do ta bën Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër e Komunës së Deçanit.

III.

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

IV.

Me Vendim njoftohen Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Arhivi i KK Deçan.

01.Nr.II-4

Deçan,dt.29.02.2016

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Jashar Dobraj



MYRESE ULAZNE NIKOHJE	
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DECANI - DEÇANI MUNICIPALITY	
Adresa: Nr. 01: Fto: <i>K.K. Deçan. AS</i>	D. Pril: B. Pril: Pril. Nr. <i>5827/1</i>
At i kërkuar: Dt. 01.03.16 Fto: <i>01</i>	D. Pril: B. Pril: Pril. Nr. <i>04.03.16</i>